AMC
COSMOTE GROUP

# RAPORTI I PERGJEGJSHMERISE SOCIALE TE KORPORATES

# CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY REPORT

# 2007



Pjesëmarrje
Participation

Pjesëmarrje
Participation

# Përmbajtja:
## Table of Contents:


**Fjala e Drejtorit Ekzekutiv**

Letter from the Chief Executive Officer

**1. Profili i Kompanisë AMC**

a. Përmbledhje e treguesve financiarë për vitin fiskal 2007
b. Misioni dhe parimet drejtuese
c. Vlerat e korporatës

AMC Company Profile
a. Key Performance Indicators Summary and Highlights for Fiscal Year 2007
b. Our Mission Statement and Guiding Principles
c. Corporate Values

**2. Drejtimi Administrativ në AMC**

Corporate Governance

**3. Strategjia e AMC-së drejt suksesit**

a. Lidhja me klientët
b. Përgjegjës ndaj furnitorëve
c. Të përkushtuar ndaj punonjësve

AMC's Strategy for Success
a. Connected to customers
b. Responsible to suppliers
c. Committed to our employees

**4. Risitë**

a. AMC – pasqyra e zhvillimit teknologjik, komunikimit dhe informacionit në Shqipëri
b. Komunikimi dhe informimi i publikut
c. Sfida e fushave elektromagnetike

Innovation
a. AMC and the Albanian Information and Communication Technology
b. Communication and information to the public
c. The Challenge of Electromagnetic Fields

**5. Angazhimi ndaj komunitetit**

a. AMC – faktor në ekonomi
b. Kontributi në shoqëri

Community Engagement
a. AMC - Key player in the economy
b. Contribution to the society

**6. Angazhimi i AMC-së ndaj mjedisit**

AMC's Commitment to the Environment

**7. Vizioni ynë për të ardhmen**

Our Vision for the Future

**8. Reagimi juaj është i rëndësishëm**

Your Feedback Matters



**Letra e Drejtorit Ekzekutiv**

Është një nder për mua t'ju prezantoj sërish raportin e përvitshëm të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës.

Konsolidimi i parimeve etike për ushtrimin e biznesit në Shqipëri është një mënyrë për t'i treguar klientëve tanë dhe të gjithë qytetarëve interesimin tonë për krijimin dhe rritjen e standardeve të jetesës për të gjithë. Është kënaqësi për mua të deklaroj që ne si kompani kemi mbështetur standardet ndërkombëtare të etikës së biznesit, ndërkohë që kemi ruajtur përkushtimin ndaj klientëve dhe punonjësve tanë.

Ne jemi të vetëdijshëm për aspektet dinamike të zhvillimit ekonomik dhe social, duke qenë njëkohësisht të vëmendshëm ndaj nevojave të komunitetit.

Kontributi ynë i vazhdueshëm që nga fillimi i aktivitetit në Shqipëri reflekton ndërgjegjësimin dhe angazhimin e kompanisë në një sërë projektesh në fushën e arsimit, kulturës, mjedisit, shëndetësisë dhe kujdesit social.

Duke qenë një nga kompanitë më të mëdha në Shqipëri, AMC është e ndërgjegjshme që shërbimet dhe kontributi i saj kanë një ndikim të konsiderueshëm në standardin dhe cilësinë e jetës. AMC ofron mundësi për një komunikim të efektshëm dhe të një cilësie të lartë, si dhe shkëmbim informacioni të shpejtë, të saktë e racional. Ne besojmë te transparenca, ndërkohë që jemi të vëmendshëm ndaj efektit social, etik dhe ekologjik të të gjithë veprimtarive tona në jetën e shoqërisë ku operojmë. Ne përpiqemi të arrijmë përsosmërinë në teknologji, teksa ndërtojmë një komunitet energjik dhe të vrullshëm.

Jam i bindur që AMC, si anëtare e grupit COSMOTE, do të vazhdojë të jetë një ndër kompanitë lider në ofrimin e shërbimeve bashkëkohore të telekomunikacionit në Shqipëri, si dhe do të prijë rrugën drejt një sjellje më të përgjegjshme dhe transparente të biznesit. Praktikat tona dhe përpjekjet e parreshtura për të përmirësuar komunitetet lokale na bëjne ne krenar për ndryshimin pozitiv që sjellim në shoqërinë ku ushtrojmë aktivitetin tonë.

Në emër të familjes AMC dëshiroj t'ju falenderoj për kohën që po kushtoni për informim të mëtejshëm rreth nesh dhe mënyrës së përgjegjëshme nëpërmjet së cilës ne ushtrojmë biznesin tonë.

Sinqerisht

## Letter from the Chief Executive Officer

**It is my honor to present once more to you our Company's annual report on responsible business conduct and corporate social responsibility.**

**Strengthening ethical principles of doing business in Albania is our way of demonstrating to our customers and all citizens that we have a vested interest in creating and enhancing living standards for everyone. I am pleased to declare that as a company we have stood up for international standards of ethical business conduct while upholding our commitment towards our customers and employees.**

**We acknowledge the dynamic aspects of the social and economic development and remain attentive to the needs of the community. Our continuing contribution since we started operating in Albania reflects our company's awareness and commitment to the society. Our vision for how we can make a difference has resulted in a diverse set of projects in education, culture, environment, health and social care.**

**Being one of the biggest companies in Albania, AMC understands that its services and contributions have a significant influence on the standard and quality of life. We provide possibilities for effective and high quality communication – prompt, accurate and rational exchange of information. We believe in transparency while being attentive to the social, ethical and ecological impacts of all our activities in the life of the society where we operate. We strive for excellence in technology while building a vibrant and thriving community.**

**I remain certain that AMC, as a member of the COSMOTE group, will continue to be one of the leaders in the modern telecommunication services in the area as well as lead the way to a more responsible and transparent corporate behavior. Our business practices and our unyielding efforts to improve the local communities will enable us to proudly claim the positive change that we bring to the society we operate.**

**On behalf of the AMC family, I want to thank you for taking your time to learn more about AMC and the responsible way that we conduct business.**

**Sincerely**

Stefanos Oktapodas

Stefanos Oktapodas





AMC, kompania nr. 1 e telefonisë celulare në Shqipëri

AMC, the leading mobile operator in Albania

# Profili i Kompanisë AMC

AMC, operatori lider i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, është pjesë e kompanisë më të madhe të ofrimit të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në Evropën Juglindore, grupit COSMOTE, me më shumë se 15 milionë abonentë në Greqi, Shqipëri, Bullgari, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Rumani.

## AMC: Një histori e vazhdueshme suksesi

***a. Përmbledhje e treguesve kryesorë financiarë për vitin fiskal 2007***

AMC është një kompani moderne në zhvillim dhe me një traditë shumëvjeçare. Ajo është gjithashtu kompania lider në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit në Shqipëri, e cila zotëron një rrjet telekomunikacioni që mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh telefonike kombëtare dhe ndërkombëtare.

AMC, pjesë e grupit COSMOTE, është kompania numër një në tregun shqiptar me 1.2 milionë abonentë, me një mbulim territori prej 86,77%, mbulim popullsie prej 98.91%, si dhe zotëruese e 52% të tregut të telefonisë së lëvizshme. Në vitin 2007, numri i abonentëve të AMC-së u rrit me 20.7%, një arritje kjo të cilën ne e pohojmë me shumë krenari. Rritja financiare e AMC-së reflekton performancën e saj të vazhdueshme në nivele të larta dhe është një nga treguesit e suksesit të përgjithshëm të kompanisë.

*Tabela 1: Përmbledhje e rezultateve financiare*

| **Shuma në milion €** | **2007** | **2006** | **ndryshimi në %** |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat | 176.2 | 151.0 | 16.7% |
| EBITDA | 109.3 | 91.0 | 20.1% |
| **Norma EBITDA** | **62.0%** | **60.3%** | **+ 1.7 pp** |
| Të ardhurat neto | 60.9 | 49.9 | 22.1% |
| Norma e të ardhurave neto | 34.6% | 33.0% | + 1.6 pp |

*Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS)*

# Company profile

AMC is the leading mobile operator in Albania and it is part of the biggest mobile – service providing company in the South – Eastern Europe, COSMOTE group with more than 15 million customers in Greece, Albania, Bulgaria, FYROM and Romania.

## AMC: An Ongoing Success story

***a. Key Performance Indicators Summary and Highlights for Fiscal 2007***

AMC is a modern and growing company with many years of tradition. AMC is also a leader in providing modern telecommunications services in Albania. AMC owns and operates a telecommunication network which covers the entire territory of the Republic of Albania, providing a wide portfolio of national and international voice services.

AMC, part of COSMOTE group, is number one in the Albanian market with 1.2 million subscribers, territory network coverage of 86.77%, population coverage of 98.91%, and with a market share of around 52%. Just in 2007 AMC's subscribers increased by 20.7%, an achievement that we are very proud to claim. AMC's financial growth shows its ongoing strong performance and it is one of the indicators of the company's overall success.

*Table 1: Summary Financial Results*[1]

| **Amounts in € million** | **2007** | **2006** | **% change** |
|---|---|---|---|
| Revenues | 176.2 | 151.0 | 16.7% |
| EBITDA | 109.3 | 91.0 | 20.1% |
| **EBITDA margin** | **62.0%** | **60.3%** | **+1.7pp** |
| Net Income | 60.9 | 49.9 | 22.1% |
| Net Income margin | 34.6% | 33.0% | +1.6pp |

*1. International Financial Reporting System (IFRS)AMC*

Të ardhurat e AMC-së për vitin 2007 ishin 16.7% më të larta se një vit më parë, duke arritur shifrën 176.2 milionë Euro. Kjo erdhi si rezultat i rritjes së numrit të abonentëve, si dhe prej rritjes së trafikut prej 22,2% krahasuar me vitin e kaluar.

EBITDA e AMC-së u rrit me 20.1% në 2007, ndërkohë që të ardhurat neto ishin 62%. Këto rezultate të suksesshme i atribuohen përpjekjeve energjike të AMC-së për të frenuar kostot, sidomos në shërbimet e interkoneksionit, si dhe hedhjes në treg të ofertave të reja për SMS, shërbimeve me vlerë të shtuar, fleksibilitetit pozitiv të tarifave ndërkombëtare dhe të ardhurave shtesë neto prej c. 60 k në tremujorin e fundit. Të ardhurat neto u rritën me 22.1% në vitin 2007, ndërsa norma e të ardhurave neto arriti 34.6%.

Rrjeti i AMC-së mbulon me sinjal 86.77% të territorit dhe 98.91% të popullsisë. Kompania ka nënshkruar marrëveshje roaming me më shumë se 371 operatorë GSM në 134 vende në mbarë botën. Gjatë vitit 2007, AMC ofroi mundësinë e përdorimit të shërbimit roaming nga abonentët e saj me parapagesë, përkatësisht në 39 rrjete të 30 vendeve (shërbimet CAMEL).

AMC ofron produktet dhe shërbimet e saj përmes pesë kompanive shpërndarëse në të gjithë vendin, si dhe nëpërmjet rrjetit të saj të dyqaneve. Gjatë vitit të kaluar, listës së dyqaneve AMC iu shtuan edhe 25 dyqane të reja, duke krijuar kështu rrjetin më të madh të dyqaneve në tregun shqiptar të telekomunikacionit.

### b. Misioni i AMC-së dhe parimet që e udhëheqin

Misioni i AMC-së: të ruajë pozicionin e saj lider në tregun e telefonisë në Shqipëri, përsa i përket suksesit financiar dhe numrit të abonentëve, duke ruajtur njëkohësisht parimet përmes të cilave synon:

AMC's revenues for the whole year were 16.7% higher than a year ago, reaching €176.2 million. This was the result of the significant expansion of AMC's customer base and a 22.2% increase in traffic compared to 2006.

AMC's EBITDA grew by 20.1% in 2007 while its net income was at 62%. These successful results correlate with AMC's aggressive efforts to contain costs mostly in interconnection, as well as AMC's launch of new SMS offers, Value Added Services (VAS), the positive elasticity on international pricing and c. 60k net additions in the last quarter. Net income increased by 22.1% in year 2007 and net income margin reached 34.6%.

AMC network covers 86.77% of the territory and 98.91% of the population. The company has concluded roaming agreements with more than 317 GSM operators in 134 countries all over the world. During 2007 AMC offered the ability to use the prepaid mobile phones while roaming in 39 networks of 30 countries (CAMEL services).

Our products and services are being offered through five distributors all over the country. The company has continually expanded its own network of local shops. During last year alone 25 new AMC shops were added, creating the biggest retail stores network in the Albanian telephony market.

### b. Company Mission Statement and Guiding Principles

AMC's Mission Statement: To uphold its leading position in the Albanian telephony market, both in terms of financial success and customer base, while maintaining our uncompromising principles we aim:



- Respektimin e të gjitha palëve të përfshira: klientët, punonjësit, aksionerët, furnitorët dhe komunitetet.
- Arritjen e shërbimeve të një cilësie të lartë.
- Krijimin e një lidhje besimi me klientët përmes transparencës së veprimeve.
- Zbatimin e parimeve pozitive dhe të përgjegjshme për manaxhimin e korporatës.
- Përkushtimin ndaj risive.
- Ruajtjen e mjedisit.
- Mbështetjen e politikave të përparuara për sigurinë dhe shëndetin.

### c. Vlerat e Korporatës

***I. Integriteti***
Ne i zhvillojmë një biznes të ligjshëm dhe të ndershëm. Respektojmë konfidencialitetin, shmangim konfliktin e interesit dhe promovojmë transparencën në të gjitha transaksionet tona.

***2. Sipërmarrje e bazuar në parime***
Ne jemi të prirur drejt disiplinës, përgjegjshmërisë, tregojmë maturi dhe ndërmarrim iniciativa, duke kontribuar si për kompaninë, ashtu dhe për shoqërinë në përgjithësi.

***3. Të orientuar ndaj klientit***
Ne i kuptojmë nevojat e klientëve tanë dhe përpiqemi që të krijojmë marrëdhënie të sinqerta për një përfitim të dyanshëm.

***4. Respekti***
Ne vlerësojmë diversitetin dhe tregojmë dinjitet dhe respekt në bashkëveprimet tona si në nivel personal, ashtu edhe në nivel korporate.

- to respect all stakeholders: the customers, employees, shareholders, suppliers, and communities,
- to strive for high quality of service,
- to establish a bond of trust with our customers through transparency of actions,
- to implement positive and responsible corporate governance,
- to commit to innovation,
- to tend for the environment,
- to support advanced health and safety policies.

### c. Corporate Values

***1. Integrity***
We conduct all affairs and business operations lawfully and honestly. We respect confidentiality, avoid conflict of interest, and promote transparency in all our transactions.

***2. Principled entrepreneurship***
We demonstrate a sense of discipline, responsibility, ingenuity and the risk-taking mentality necessary to generate the greatest contribution to the company and society.

***3. Customer focus***
We apprehend our customers' needs and strive to develop sincere relations for mutual benefit.

***4. Respect***
We appreciate the value of diversity and incorporate dignity and respect in our interactions on personal and corporate level.



Çdo e drejtë jep një përgjegjësi, çdo mundësi, një angazhim;
çdo zotërim, një detyrim

Every right implies a responsibility; every opportunity, an obligation;
every possession, a duty



# Drejtimi Administrativ

Si pjesë e Grupit COSMOTE, AMC iu përmbahet parimeve për një drejtim administrativ efikas, duke respektuar kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe duke krijuar një sërë praktikash për të prodhuar vlera afatgjata për kompaninë.

**Elementët kryesorë të drejtimit të brendëshëm të AMC-së janë:**

- Bordi Drejtues, i cili përcakton politikat dhe strategjinë e përgjithshme të AMC-së, si dhe mbikqyr menaxhimin operacional dhe të gjithë aktivitetin e kompanisë. Bordi Drejtues mblidhet një herë në muaj.
- Drejtori Ekzekutiv, i cili është përgjegjës për menaxhimin operacional të kompanisë.
- Këshilli Mbikqyrës, i cili mbikqyr të gjitha aktivitetet e Bordit Drejtues. Ky këshill mblidhet katër herë në vit.

# Governance at AMC

As part of COSMOTE Group, AMC has adopted principles of good governance abiding by the laws and regulatory frameworks as well as developing a series of best practices to generate long-term value for the company.

**The key elements of corporate governance at AMC are:**

- A Board of Directors that defines the general policies and strategy of AMC and supervises operational management and the total activity of the company. The Board of Directors meets on a monthly basis.
- A chief executive officer (CEO) who assumes the primary responsibility for operational management.
- A Supervisory Board which supervises the activities of the Board of directors. It meets four times per year.



E ardhmja nuk është krejtësisht jashtë kontrollit, është produkt i punës tonë

The future is not completely beyond our control.
It is the work of our own hands

## Strategjia e AMC-së drejt suksesit

Ashtu si gjithë kompanitë e përparuara në ditët e sotme, AMC synon ta mbështesë aktivitetin e saj të përditshëm në parime etike të qëndrueshme.

Ne përpiqemi që logo-ja "AMC" të jetë e lidhur me imazhin e një kompanie lider në fushën e telekomunikacionit, duke ju mundësuar shqiptarëve një mënyrë jetese bashkëkohore dhe komode e njëkohësisht duke u ndjerë faktor ndryshimi në shoqërinë shqiptare. Ne kemi fituar besimin e klientëve tanë dhe si këmbim duam t'ju sigurojmë atyre dhe shoqërisë në tërësi që jemi seriozë në zotimin tonë për të përmirësuar mirëqënien e komunitetit dhe mjedisit ku operojmë.

**a. Lidhja me klientët**

Synimi ynë kryesor është që t'ju sigurojmë klientëve shërbime dhe produkte të një cilësie të lartë dhe të përmbushim sa më mirë kërkesat e tyre. Ne përpiqemi të ofrojmë informacion të saktë e të kuptueshëm në lidhje me shërbimet që ofrojmë, si dhe t'ju sigurojmë klientëve që ne jemi vetëm një telefonatë apo vetëm një hap larg tyre. Gjatë gjithë vitit 2007 ne zgjeruam rrjetin tonë të pikave të shitjes, duke hapur edhe 25 pika shitje të tjera. Në total, rrjeti i dyqaneve AMC përbëhet nga 57 pika shitjeje, duke i sjellë shërbimet tona më afër klientëve. Brenda strukturës së shërbimeve, ne kemi zgjeruar gamën e paketave me produkte e shërbime të reja si:

## AMC's Strategy for Success

AMC, as all advanced companies today, focuses more on the application of sustainable development principles.

We feel committed to not only improving the quality of our products and services, but also enhancing the quality of life in the communities we serve. We want to ensure that the AMC brand is associated with the image of a telecommunication leader bringing Albanians a modern and comfortable life style. We take pride on our work as an agent of change in the Albanian society. We have earned the trust of our customers and in return want to ensure them and the society as a whole that we are solemn in our pledge to improve the well-being of the community and the environment where we operate.

**a. Connected to Customers**

Our main goal is to provide the customers with high quality products and services and to best satisfy their demands. We strive to provide clear and easily accessible information on the services we provide as well as to ensure that we are only one phone call or one short walk away from our customers. Throughout 2007, we extended our AMC network sales points by opening 25 additional locations. In total, the network consists of 57 sales points. The expansion in the sales network has made our services more available and convenient for the customers. Within the structure of our services we have extended our portfolio with new products and services such as:

• “What’s up”, paketa e komunikimit për të rinjtë, e cila ju jep atyre mundësi të shpenzojnë më pak dhe të komunikojnë më shumë me njëri-tjetrin nëpërmjet SMS-ve dhe MMS-ve më të lira brenda grupit, si dhe me tarifa më të lira për thirrjet ndërmjet anëtarëve të grupit What’s Up.
• Teknologjinë e avancuar EDGE, e cila mundëson transmetim të shpejtë dhe të sigurt të dhënash me një shpejtësi shkarkimi dhe navigimi deri në katër herë më të madhe se teknologjia GPRS.
• Shërbimin Wireless, i cili mundëson lidhje të shpejtë dhe të lehtë me internetin nëpërmjet një kompjuteri, laptopi apo një telefoni celular, duke përdorur teknologjinë GPRS ose EDGE.
• Shërbimin “AMC Easy”, i cili është një mënyrë alternative për të përdorur shpejt dhe lehtë disa nga shërbimet më të kërkuara të AMC-së.

**b. Përgjegjëse ndaj furnitorëve**

Sjellja jonë e përgjegjshme pasqyrohet gjithashtu edhe në raport me furnitorët. Ne sigurohemi përherë që përzgjedhja e furnitorëve dhe partnerëve tanë të biznesit të jetë transparente dhe që ata të jenë të licensuar në fushën e tyre të biznesit, të respektojnë rregulloret dhe standardet dhe të përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Kompania jonë përkrah bashkëpunimin afatgjatë me furnitorë të besueshëm.

Ne synojmë marrëdhënie tregtare afatgjata me furnitorët tanë, të bazuara në ndershmëri dhe mirëbesim reciprok.

**c. Të përkushtuar ndaj punonjësve**

Më 31 dhjetor 2007, numri i punonjësve të kompanisë sonë rezultoi 516, nga të cilët 55.5% janë femra. Mosha mesatare e punonjësve tanë është 33.




*Figura I: Shpërndarja e punonjësve në AMC*

• “What’s up,” a new youth prepaid package, which allows young people to spend less and communicate more with each-other, through cheaper on-group SMS & MMS, as well as lower tariffs for calls between What’s Up members.
• Innovative EDGE technology which offers increased data transfer rates and upgraded data transfer reliability, providing downloading and browsing speeds up to four-times faster than GPRS
• Wireless Internet service which enables fast and easy internet access through a desktop or laptop by using GPRS or EDGE or even from the handset
• New service “AMC Easy” which is an alternative to access some of the most popular AMC services.

**b. Responsible to suppliers**

Our responsible corporate behavior extends to our relationship with suppliers as well. We always ensure that the selection of our suppliers and business partners is transparent and that our suppliers are properly licensed in their business areas, abide by regulations and standards, and are in compliance with the applicable Albanian laws. Our company favors long term cooperation with reliable suppliers.

We strive for long-lasting commercial relations with our suppliers that are based on honesty and trust.

**c. Committed to our employees**

As of December 31st, 2007 our company employs 516 employees out of which 55.5% are women. The average age of our employees is 33.




Figure I: Distribution of Employment at AMC

**Zhvillimi dhe trajnimi i punonjësve**

Arsimimi dhe trajnimi i vazhdueshëm janë domosdoshmëri në botën e teknologjisë së informacionit. AMC e konsideron trajnimin dhe arsimimin e vazhdueshëm të punonjësve të saj një element të nevojshëm për suksesin e kompanisë, duke qenë e bindur që suksesi lidhet ngushtë me zhvillimin e punonjësve.

Vitin e kaluar, kompania zhvilloi më shumë se 900 orë trajnimi, të ofruara gjatë gjithë vitit sipas një programi të planifikuar. Trajnimet dhe workshop-et, të përqëndruara kryesisht te teknologjia, aftësitë personale, manaxhimi, produktet dhe shërbimet, janë realizuar në bashkëpunim me institucione arsimore të akredituara, si dhe me lektorë të brendshëm.

**Shpërblimi i punonjësve**

Sistemi i shpërblimit i përdorur në kompaninë tonë reflekton si mjedisin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm, duke siguruar që shpërblimi në bazë të performancës është i drejtë, motivues dhe konkurues në tregun e punës.

Ne ofrojmë përfitime të shumta sociale për punonjësit tanë në fushën e kujdesit shëndetësor, argëtimit, aktiviteteve kulturore etj.

***Ne ofrojmë edhe përfitime të tjera, të tilla si:***

• Programe tarifore për të gjithë punonjësit me çmime veçanërisht të lira dhe një numër me po të njëjtin program tarifor për të afërmit e tyre.

• Shpërblime dhe dhurata në raste festash.

• Politika elastike për lejet nga puna dhe kujdes për nevojat e veçanta.

• Mbulim i kostove të vizitave mjeksore dhe kujdesit shëndetësor.

• Marrëveshje të veçanta me kompanitë e tjera për tarifa të reduktuara për punonjësit tanë.

• Organizim i aktiviteteve sportive me qëllim përmirësimin e jetës profesionale dhe personale të punonjësve.

**Employee development and training**

Lifelong education and continuous training are imperative in the world of telecommunication technologies. AMC considers the continuous training and education of its employees a necessary element for the success of the company. We believe strongly that our success is closely interrelated to the development of our individual employees.

Last year the company conducted more than 900 training hours, offered all through out the year according to a planned schedule. The training and workshops have focused on technology, soft skills, management, product & services, in cooperation with accredited educational institutions as well as with internal lecturers.

**Employee remuneration**

The remuneration system used in our company reflects both the internal and external environment to ensure that the reward of performance is fair, motivating, and also competitive in the labour market.

In the field of social benefits, the flexible benefit system has proved to be convenient, enabling our employees to choose from a wide range of benefits in the areas of health care, recreation, cultural events etc. AMC offers competitive additional benefits, such as:

• Corporate mobile phones for all employees with special inexpensive programs and a bonus corporate phone of the same program for their family members.

• Gifts and special rewards on special occasions.

• Flexible leave policy, attentive to special needs.

• Covering costs of medical examinations and health care.

• Special agreements with other local companies for employee discounts on products and services.

• Organization of sports activities and other events with an aim to balance employees’ professional and personal life.

**Me qëllim që të jemi kompania më e mirë në Shqipëri, ne synojmë që të punësojmë, të zhvillojmë, të motivojmë dhe të mbajmë profesionistët më të mirë. Ne aspirojmë të arrijmë përsosmërinë si kompani dhe si individë nëpërmjet një manaxhimi burimesh njerëzore të orientuar drejt biznesit dhe tregut.**

*"Rritja ime profesionale në AMC ka qenë shumë motivuese. Stafi manaxhues i ka dëgjuar idetë e mia, duke më mbështetur dhe udhëzuar. AMC ka qenë padyshim eksperienca më shpërblyese e karrierës sime".*
*Marinela Benga – Departamenti i Burimeve Njerëzore*

*"AMC është një kompani që respekton punonjësit e saj, i bën ata të kenë besim tek aftësitë e tyre, si dhe i nxit për t'u angazhuar më tepër".*
*Arjola Mehmeti – Departamenti i Marketingut*

**Kushtet e punës**

Një ndër prioritetet kryesore të AMC-së është krijimi i një mjedisi të shkëlqyer pune, duke ju dhënë mundësi punonjësve të shfaqin aftësitë e tyre, në mënyrë që të përfitojnë si ata vetë, ashtu edhe kompania.

Në vitin 2007, AMC i pajisi ambjentet e saj me kuti të ndihmës së shpejtë, ndërsa 5% e punonjësve janë trajnuar si të veprojnë në raste emergjence në vendin e punës. Gjithashtu, ata që punojnë në ambjente ku ka tension të lartë, janë trajnuar çdo vit nga Instituti i Energjisë Elektrike, si dhe janë pajisur me licensën përkatëse.

**In order to be the best company in Albania we aim to hire, develop, motivate and retain the best professionals. We aspire to achieve both company and individual excellence at AMC through business and market oriented human resources management.**

*"My professional growth with AMC has been very rewarding. The management staff listened to my ideas, and offer support and guidance. AMC has without a doubt, been the most rewarding experience of my career."*
*Marinela Benga – Human Resources Department*

*"AMC is a company that respects its employees, make them known to have confidence in their skills and encourage them to get involved"*
*Arjola Mehmeti – Marketing Department*

**Working Conditions**

A key priority for AMC is to provide an excellent working environment that enables employees to perform to the best of their abilities, benefiting their own as well as the company's development.

AMC in 2007 has equipped its premises with First Aid Boxes while CPR training has been provided for 5% of employees to act in case of workplace emergency. Moreover, employees working on high voltage environments are trained yearly by the Albanian Electrical Institute and awarded with the required license.








AMC është e angazhuar ndaj shoqërisë për një të ardhme më të mirë
AMC is committed to society for a better future






Mënyra më e mirë për të gjetur një ide të mirë, është të kesh shumë ide

The best way to have a good idea is to have a lot of ideas



# Risitë

**a. AMC, pasqyra e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit**

Duke i shërbyer shoqërisë shqiptare për më shumë se një dekadë, mund të themi me siguri që AMC e ka ndihmuar Shqipërinë të ecë me të njëjtin hap si vendet e tjera evropiane në fushën e teknologjisë dhe sidomos në atë të telefonisë celulare.

AMC ka marrë rol drejtues në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Shqipëri. Pasi mundësoi thirrjen e parë me celular në historinë e Shqipërisë, AMC futi shumë shpejt në treg shërbimin SMS, MMS dhe GPRS për të gjithë abonentët e saj. Shërbimet e tjera të përparuara si ai i teknologjisë EDGE dhe internetit janë ndër risitë më të fundit teknologjike që janë instaluar në rrjetin AMC.

AMC është nismëtare e teknologjisë në Shqipëri, duke qenë një ndër kompanitë e para dhe më të suksesshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Rajon. AMC është e angazhuar në një proces të vazhdueshëm për modernizimin e infrastrukturës së saj të brendshme dhe të jashtme me qëllim krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm pune, duke ruajtur standardet e saj të shkëlqyera në aspektin e burimeve njerëzore. Rrjeti i gjerë i mbulimit prej 86.77% të territorit, duke arritur madje edhe në zonat më të thella të vendit dhe mbulimi prej 98.91% të popullsisë është gjithashtu provë e përkushtimit tonë për ta bërë telefoninë celulare të prekshme nga të gjithë.

Gjatë vitit 2007, AMC arriti të përmirësojë me sukses 75% të teknologjisë së saj dhe procesi është ende në vazhdim. Duke dashur t'ju ofrojmë shërbime pa ndërprerje klientëve tanë, antenat tona janë të pajisura me gjeneratorë, ndërkohë që në zonat urbane dhe ato të populluara përdoren gjeneratorë silenciozë për të shmanguar ndotjen akustike. Ky është një investim i rëndësishëm që u garanton klientëve tanë një shërbim të shkëlqyer dhe të vazhdueshëm nga ana jonë.

# Innovation

**a. AMC, the face of ICT development in Albania**

Serving the Albanian society for more than a decade, we can say for certain that AMC has helped Albania maintain the same pace as other European countries in the technological field, and particularly in mobile telephony.

AMC has taken a leading role in the Albanian Information and Communications Technology (ICT). After enabling the first mobile call in the history of Albania, AMC quickly introduced SMS, MMS and GPRS services to all of its subscribers. The further enhanced EDGE and Internet services are among the latest technological innovations to be implemented in our network.

AMC is a pioneer of technology in Albania, being among the first and most successful companies of ICT in the region. AMC is involved in a continuous process of upgrading its internal and external infrastructure in order to achieve the optimum working environment and maintain excellent human resources standards.

The extensive network coverage, 86.77% of the territory, reaching even the most remote areas of the country and population coverage of 98.91%, is also evidence of our commitment to make mobile telephony available to everyone.

During 2007 AMC has succeeded to upgrade 75% of its technology, and the process is still ongoing. In order to uninterruptedly offer our services to our customers, all our base stations are equipped with generators and in urban and populated areas noise-free generators are being used to avoid noise pollution. Taking into consideration the electricity shortage during 2007, this is an important investment that ensures our customers of our continuous excellent service.

**b. Komunikimi dhe informimi i publikut**

Çështja e sigurisë në telefoninë celulare lidhet jo vetëm me investimet tona për një teknologji të standardeve bashkëkohore, por edhe me informimin e vazhdueshëm të qytetarëve rreth aktiviteteve tona dhe efektit të tyre në shoqëri. Në këtë kuadër, AMC ka botuar broshura informative per efeket që kanë në mjedis dhe në shëndetin e njeriut antenat celulare, ku ekspertë të fushës së rrjetit GSM japin përgjigje dhe informacione me baza shkencore. Kjo broshurë është pjesë e strategjisë së AMC-së për përgjegjësinë sociale, e cila synon ndër të tjera të rrisë nivelin e transaprencës dhe të vendosë ura komunikimi me qytetarët.

AMC dhe Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT), pas kërkesave nga publiku, kanë kryer një sërë matjesh të fushës elektromagnetike. Rezultatet e matjeve janë publikuar nga ERT.

**c. Sfida e fushave elektromagnetike**

Të gjitha studimet kanë mbështetur vazhdimisht konkluzionin shkencor se fushat elektromagnetike, të mbajtura brenda kufijve të caktuar nga standardet dhe rekomandimet e bëra në mbarë botën, nuk paraqesin asnjë efekt të padëshiruar.

Sfida kryesore mbetet t'i sigurojmë klientët se produktet tona nuk paraqesin rrezik shëndetësor dhe se janë të sigurta. Në përgjigje të kësaj sfide, AMC i projekton produktet e saj në përputhje me të gjitha standardet dhe rekomandimet botërore për sigurinë dhe publikon informacionin shkencor.

Në të ardhmen e afërt, AMC pritet të implementojë gjeneratën e re të stacioneve bazë, që konsiderohen si më të padëmshmit për mjedisin dhe që përmbushin normativat më të fundit të BE-së.

**b. Communication and information to the public**

We, at AMC, are sensitive to concerns about mobile safety and are committed not only to invest the best technology in accordance with all standards, but also to provide customers with transparent and constant information on our operations and the impact on society. In this framework we have published the informative booklet on GSM Networking Antennas and their impact on the environment and human health. The booklet provides answers by experts in the field of GSM Networking to the most Frequently Asked Questions. The booklet is part of AMC's social responsibility strategy to inform the public via scientific evidence and open communication with the community in which it operates.

A series of measurements of electromagnetic field (EMF) have been conducted by AMC and Telecommunication Regulatory Entity (TRE) based on public requests. The results from these measurements were published by TRE.

**c. The challenge of EMF**

All research consistently supports the scientific conclusion that the electromagnetic field operated within the limits prescribed by standards and recommendations around the world, presents no adverse effect.

The main challenge therefore remains to ensure our customers that our products are safe and pose no health risks. To address this we design our products to meet all relevant safety standards and recommendation globally and communicate the latest scientific information as it becomes available.

The new generation of base stations, considered the most environmental-friendly of their kind and in full compliance with the latest EU regulations, is expected to be implemented in the near future.









Përgjegjësia ndaj shoqërisë është në themel të veprimtarisë tonë të përditshme

Our responsibility towards society is integrated into our daily operations







Suksesi në biznes kërkon sjellien e ndryshimeve në komunitet ku jetojmë, punojmë dhe shërbejmë

Succeeding in business needs making difference in the communities in which we live, work, and serve



# Angazhimi ndaj komunitetit

## a. AMC - faktor në ekonomi

AMC luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, jo vetëm përmes produkteve dhe shërbimeve që ofron, por edhe përmes përkushtimit ndaj komunitetit dhe detyrimeve tatimore. Taksat e Korporatës paguhen në përputhje me legjislacionin dhe praktikën shqiptare. Përmes veprimtarisë sonë, ne mbledhim edhe taksa jo të drejtpërdrejta, si taksa mbi shitjet apo tatimin mbi vlerën e shtuar. Shuma totale e taksave dhe tatimeve të paguara nga korporata në vitin 2007 ka qenë mbi 43 milionë Euro. Përgjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit në Shqipëri, shumat e derdhura nga AMC për taksa direkte dhe kontributet shoqërore ka ardhur duke u rritur.

*Tabela 2: Kontributet e AMC-së në ekonominë e vendit*

| Shuma në € (Euro) | 2006 | 2007 |
|---|---|---|
| Kontributi në taksa direkte | 34,091,434 | 42,294,013 |
| Shuma e kontribu-teve shoqërore | 989,338 | 1,001,52 |

AMC është gjithashtu një nga punëdhënësit më të mëdhenj në vend, me mbi 500 punonjës, të cilëve u ofron paketa të plota shpërblyese.

Duke qenë e vetëdijshme për rolin e saj si një prej aktorëve më të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, AMC kontribuon gjithashtu edhe në zhvillimin ekonomik dhe social të Rajonit përmes partneritetit me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

# Community Engagement

## a. Key Player in the Economy

AMC plays a large role in the country's economy not only through its products and services, but also through our community involvement and tax contributions.

Corporate taxes are paid in accordance with Albanian legislation and practices. We also collect indirect taxes such as sales tax and value added tax through our operations. The total corporate taxes paid in 2007 are more than 43 million Euros. The contribution in direct taxes and Social security contribution has increased through out the years that AMC has operated in Albania.

*Table 2: AMC's Contributions to the Local Economy*

| Amount in € | 2006 | 2007 |
|---|---|---|
| The contribution to direct taxes | 34,091,434 | 42,294,013 |
| The social security amount | 989,338 | 1,001,52 |

AMC is one of the biggest employers in the country, with over 500 employees, to which we offer full enumeration packages.

AMC is fully aware of its role as an important player in the Albanian economy. Through its partnerships with national and international organizations, our company contributes to the social and economic development in the region.

AMC si pjesë e Grupit COSMOTE, grupi i telekomunikacioneve me shtrirjen më të madhe në Evropën Juglindore e me performancë të qëndrueshme dhe të pandërprerë gjatë viteve, është një tjetër tregues pozitiv i progresit të vendit në rrugën e integrimit drejt Evropës.

AMC ofron shërbimet bazë dhe të avancuara për më shumë se 1 milion abonentë. Ne ofrojmë zgjidhje praktike për nevojat e përditshme dhe teknologji moderne për t'ju përgjigjur kërkesave më të avancuara për komunikim. Përmes vlerave që AMC sjell në sektorin e telekomunikacionit, ajo ndihmon bizneset në uljen e kostove operative, si dhe në rritjen e produktivitetit të shoqërisë.

**b. Kontributi në shoqëri**

Strategjia e kompanisë sonë ndaj shoqërisë pasqyron përgjegjësinë tonë si një aktor i fuqishëm ekonomik në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe krijimin e një mjedisi shoqëror energjik.

Përmes investimeve në projektet sociale në Shqipëri, AMC synon të jap shembull në komunitetin e biznesit, për të kontribuar më tepër për shoqërinë në fushat e arsimit, kujdesit shëndetësor, mjedisit, kulturës dhe sporteve.

AMC ka përfshirë parimet e përgjegjësisë sociale në të gjitha strategjitë e saj, duke qenë e vetëdijshme se suksesi i saj ndërthuret me suksesin e individëve, si dhe të komunitetit ku operon. Duke qenë se ne veprojmë në bazë të parimeve të përgjegjësisë sociale, jemi përfshirë në aktivitete të rëndësishme, projekte të komunitetit, punë vullnetare, si dhe në kontribute të tjera sociale. Shkalla e lartë e projekteve në të cilat jemi përfshirë tregon dashamirësinë ndaj gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.




*Figura 2: Kontributet e AMC-së të ndara sipas fushave*

The presence of AMC as part of COSMOTE Group, the telecommunication group with the widest presence in South Eastern Europe, and its solid performance over the years is another positive demonstration of the country's progress on its way towards European integration.

AMC offers its portfolio of basic and advanced services to more than 1 million subscribers. We offer practical solutions for everyday needs, as well as cutting edge technology for the most advanced communication demands in the country. Through the values we bring in the telecommunication sector, we help businesses to reduce the operational business costs and enhance the productivity.

**b. Contribution to the Society**

Our company's strategy towards society reflects our responsibility as a strong economic entity in Albania, improving the lives of our customers and encouraging a vibrant social environment.

Through our investment in social projects in Albania, AMC seeks to set an example in the business community, to encourage greater contributions to the society in areas such as education, health care, environment, culture and sports.

AMC has incorporated the social responsibility principles into all its strategies. We acknowledge that our success is interrelated with the success of the individuals as well as the community where we operate. AMC acts on its social responsibility principles by being heavily involved in important activities, community projects, volunteer work, as well as other social contributions. The wide range of the projects that we are involved demonstrates our benevolence towards all members of the society.




*Figure 2: AMC's Contributions by Field*



**Kujdesi shëndetësor dhe social**

Duke vlerësuar me seriozitetin e duhur problemet që hasin grupe të caktuara të shoqërisë dhe nevojën që ato kanë për mbështeje, AMC është përfshirë në shumë nisma e partneritete me institucione qeveritare e organizata jo-fitimprurëse.

Gjatë vitit 2007, ndihma e AMC-së në fushën e kujdesit social ka qenë e fokusuar përgjithësisht te fëmijët me probleme psiko-fizike, pleqtë e vetmuar e grupe te tjera ne nevoje.

Në kuadër të mbështetjes së grupeve në nevojë, AMC ka financuar Kampionatin Kombëtar të Futbollit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, ku kanë marrë pjesë fëmijë me aftësi të kufizuara nga qytetet e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës, Elbasanit, Kavajës dhe Shkodrës.

AMC ka mbështetur fëmijët në nevojë nëpërmjet një sërë iniciativash, në përpjekje të integrimit të tyre social. Në këtë kuadër, AMC i ka dhuruar Institutit të Nxënësve të Verbër një printer për alfabetin "Brajl", i cili ndihmon fëmjët e verbër të marrin pjesë në procesin e të mësuarit dhe të integrohen në jetën e përditshme. Pavarësisht përpjekjeve plot përkushtim të Institutit për të përmirësuar kushtet e mësimit, nxënësit akoma ishin në nevojë për tekste shkollore dhe publikime në alfabetin "Brajl". Printeri i dhuruar nga AMC ishte një kontribut mjaft i vlefshëm për 60 nxënësit e kësaj shkolle dhe vetëm një nga mënyrat për të treguar përkushtim dhe mbështetje ndaj personave më pak të privilegjuar të shoqërisë, sidomos kur bëhet fjalë për arsimimin e brezit të ri.

AMC në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar është përfshirë në një sërë aktivitetesh në ndihmë të njerëzve në nevojë, ku përfshihen persona në vështirësi ekonomike. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Urisë, AMC organizoi një fushatë sensibilizuese për të ndihmuar njerëzit në nevojë, si dhe një fushatë për mbledhjen e fondeve me anën e SMS-ve. Fondet e mbledhura gjatë fushatës, së bashku me një kontribut të AMC-së ju dhuruan shtëpive të të moshuarve në të gjithë vendin.

**Health and social care**

AMC has participated in several initiatives and partnerships with government institutions and Non-Governmental Organizations (NGO-s), focusing on fostering and rehabilitating the people in need.

In 2007 AMC's contribution to social care and welfare has been concentrated mainly on children with psychophysical problems, disadvantaged senior citizens as well as other people in need of support.

During 2007, AMC has supported the Football Championship for Disabled Children, aimed at helping the disadvantaged groups of the society. Disabled children from the cities of Tirana, Durres, Vlora, Korca, Elbasan, Kavaja, and Shkodra participated in the national football championship.

AMC has provided economic support for many initiatives assisting the disadvantaged Albanian children in an effort for social integration. In this context AMC has donated a Braille printer to the Institute of Blind Pupils, the only institution of its kind in the country, which enables the blind children to participate in the learning process and become integrated into the everyday life. Despite the dedicated efforts of the Institute to improve the learning conditions, the students were still in need of school texts and publications in Braille alphabet. The existing literature was handwritten, and the process was challenging because of the technology used for the Braille alphabet. The high tech printer donated by AMC was a precious contribution to the 60 students of this school. The support that AMC gave to the Institute is just one way of showing our dedication to the under-privileged people in the society, especially when it comes to equipping the young generation with knowledge and education.

AMC has undertaken several activities in cooperation with the Red Cross of Albania, which have served the most vulnerable people in the society, such as individuals facing economic difficulties, especially those that live in elderly nursing homes. In the framework of the International Day against Hunger, AMC organized an awareness campaign to help people in need, as well as an SMS fundraising campaign.

Më 1 Dhjetor 2007, AMC në bashkëpunim me UNICEF-in, ndërmori një fushatë për të mbledhur fonde për fëmijët shqiptarë të infektuar me HIV dhe familjet e tyre. Fondet e mbledhura me këtë rast u përdorën për të mbuluar shpenzime si transporti, trajtimet mjeksore dhe medikamente.

Në kudër të aktiviteteve të organizuara me rastin e festave të fundvitit, AMC ëhstë bashkuar me fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijët e komunitetit rom dhe pacientët e vegjël të spitalit të fëmijëve në Tiranë, duke shpërndarë për ta dhurata të ndryshme e te tjera ndihma financiare.

Në vijim të qëllimit për të siguruar mbështetje dhe ndihmë për grupet e njerëzve në nevojë, AMC gjatë ditëve të fundit të vitit 2007 është përfshirë në një projekt vullnetar në ndihmë të të gjitha jetimoreve dhe shtëpive të të moshuarve në Shqipëri. Përfaqësues të kompanisë AMC kanë bërë vizita në të gjitha jetimoret dhe shtëpitë e të moshuarve, duke dhuruar veshje, lodra, batanije, çarçafë dhe pajisje shtëpiake më qëllim që t'ju krijojë një atmosferë të ngrohtë dhe familjare këtyre grupeve në nevojë. Gjithashtu, AMC organizoi darkën tradicionale të Vitit të Ri për të gjithë banorët e këtyre qëndrave.

Duke qënë e vetëdijshme për problemin e papunësisë ne vend, AMC në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka mbështetur Panairin e Punës në Shqipëri, duke kontribuar në zbutjen e papunësisë në vend. Gjatë këtij viti kanë qenë rreth 60 kompani ndërkombëtare dhe shqiptare, të cilat kanë ofruar më shumë se 460 vende të reja pune për njerëz me formim të ndryshëm profesional.

The funds raised during the campaign along with a generous AMC contribution were sent to elderly nursing homes all over the country to support their needs for equipments and other necessary items.

On December 1, 2007 AMC in cooperation with UNICEF Albania launched an SMS fundraising campaign for HIV infected Albanian Children and their families. The funds raised during this campaign were used to cover costs such as transportation, treatments and medicine.

As part of its end-of-year activities, for several years now, AMC has organized parties for children of police officers who lost their lives in the line of duty, Roma children, and young patients of the Children's Hospital of Tirana. AMC provided the children with many gift packages and other forms of financial aid.

Following our goal of providing support and comfort to disadvantaged groups, AMC has initiated a special volunteer project targeting all orphanages and elderly nursing homes in Albania. During the last days of 2007 AMC representatives visited the orphanages and elderly nursing homes all around the country, donating several gifts such as clothes, toys, blankets, sheets and household appliances designed to meet the residents' special requests. A New Year's traditional dinner for all residents of the centers was organized and financed by AMC.

Issues such as unemployment have a particular sensitivity in the Albanian community. AMC acknowledges the problem with unemployment in the country and that is why for the second year in a row it has given its support to the Labor Fair in Albania.



Gjatë vitit 2007, AMC në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe UNICEF-in, ka kontribuar në botimin e manualit "Për Shëndetin e Fëmijës".

Ky botim përqëndrohet te kujdesi ndaj fëmijëve deri në moshën 14 vjeç dhe është manuali më i rëndësishëm për prindërit dhe mjekët.

Manuali shërben si një regjistër, ku mbahen të dhënat e nevojshme për nënën dhe mjekun, duke siguruar informacion të saktë dhe të plotë për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Të dhënat e manualit tregojnë kontrollet që i janë bërë fëmijës, trajtimet mjekësore dhe karakteristikat gjatë periudhës së rritjes, informacion ky i vlefshëm për referencë mjekësore dhe prindërore.

Një tjetër kontribut i vlefshëm i AMC-së në fushën e kujdesit social ka qenë projekti "Kanuni", i cili është projektuar në trajtën e një albumi fotografik me foto nga jeta reale e familjeve të ngujuara për shkak të ligjeve të Kanunit.

Ky projekt është lançuar dhe më pas prezantuar në një tavolinë të rrumbullakët të organizuar nga Forumi i Opinionit të Lirë, Fondacioni Soros dhe Ashley & Holmes, Tiranë. Albumi dhe tavolina e rrumbullakët kishin për qëllim të sillnin në vëmendjen e shoqërisë shqiptare çështjen delikate të fenomenit të ngujimit, si dhe t'ju vij në ndihmë familjeve në nevojë.

Me këtë rast u paraqit dhe një projekt-propozim për ligjin "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit për Parandalimin dhe Luftimin e Gjakmarrjes".

Around 60 international and Albanian companies offer about 460 new vacancies each year, available to people of different backgrounds. Partnering with the Ministry of Labor, Social Affairs and Equal Opportunities, AMC contributes to fight against unemployment in the country.

During 2007 AMC also contributed to the publication of the "Booklet of Child Health", in collaboration with the Albanian Ministry of Health and UNICEF.

The publication targets children age 14 and under aiming to be the premier child care handbook for parents and medical practitioners. The booklet serves as a hard-copy record-keeper for mothers and doctors, providing accurate and complete data on the growth and development of a child.

The booklet records show child examinations, medical treatments, and child characteristics during the growth period, information useful for parental and medical reference alike.

Another valuable contribution of AMC in the field of social care was the "Kanuni" project. A photo album featuring real life pictures of Albanian families isolated due to the Kanun laws was released and then presented in "Together against Blood Feud" round table organized by The Free Opinion Forum, Soros Foundation and Ashley & Holmes Tirana. The album and the round table organized by AMC aimed to bring the issue of the Kanun to the attention of the Albanian society as well as to help the suffering families. A draft-proposal to the law "On the Organization and Functioning of the Committee for Prevention and Fight against Blood Feud" was also presented during the event.

## Arsimi

AMC është e vetëdijshme se arsimimi është një element i rëndësishëm, i cili ndikon si në zhvillimin ekonomik, ashtu dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Problemet e procesit të tranzicionit në Shqipëri janë reflektuar edhe në sistemin e arsimit. Duke besuar që hapi i parë drejt ndryshimit të së ardhmes është rritja e nivelit arsimor të brezit të ri, AMC ka dhënë mbështetjen e saj përmes një sërë projektesh, të cilat u adresohen hallkave të ndryshme të këtij sistemi.

Gjatë vitit 2007, projekti ambicioz "Shqipëria lexon" një bashkëpunim i AMC-së me UNICEF-in dhe Ministrinë e Arsimit, është zbatuar me sukses në 36 shkolla në të gjithë vendin. Nëpërmjet pajisjes së shkollave me nga një bilbliotekë, ky projekt synon të inkurajojë kulturën e të lexuarit te rreth njëzet mijë fëmijë, por edhe te banorët e tjerë të komunitetit. Tashmë fëmijë nga zona të izoluara kanë mundësi të shfrytëzojnë biblioteka cilësore dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre që në moshë të vogël.

Në përpjekjet e saj për të përmirësuar arsimin publik në Shqipëri, AMC ka qënë mbështetëse e inciativës së Ministrisë së Arsimit "SMS: Shkolla Prindit". Në mënyrë që të nxitet komunikimi ndërmjet shkollave dhe prindërve, AMC u ka dhuruar drejtuesëve të shkollave në Tiranë dhe Durrës 100 karta SIM me SMS falas, të cilat do të përdoren nga persona përgjegjës për të njoftuar prindërit në lidhje me mungesat e nxënësve apo për çështje të tjera që lidhen me ecurinë e tyre në shkollë. AMC ka mbështetur këtë nismë duke e konsideruar bashkëpunimin mes institucioneve arsimore dhe familjeve si çelësin drejt suksesit të brezit të ardhshëm.

Për të gjashtin vit radhazi, AMC u dhuroi bursa 15 nxënësve të diplomuar me rezultatet më të mira në shkollat e mesme, duke pasur si qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit, nxitjen e arsimit të lartë, si dhe krijimin e kapaciteteve njerëzore të qëndrueshme, nga të cilët do të përfitojë si sistemi publik ashtu dhe ai privat.

## Education

AMC is aware that education is an important element to future economic development as well as to improving the quality of life in the country. The education system in Albania, unfortunately, has suffered tremendously as a result of the transitional process. Believing that the very first step towards changing the future is to equip the next generation with top-quality education, AMC provided strong educational support in 2007 through numerous projects.

We are proud to report that the project "Albania Reads," which was enabled through the collaboration of AMC with UNICEF and the Ministry of Education, was successfully implemented through out the year 2007. This project has made it possible for 36 schools all around the country to have a sizable student library, encouraging a culture of reading for twenty thousand children and beyond in the local communities. Children from marginalized areas have now access to quality libraries, encouraging them to learn from early in life.

In its efforts to improve public education in Albania, AMC has been a proud supporter of the Ministry of Education initiative "SMS: School to Parent." In order to increase the line of communication between schools and parents as well as to encourage parental involvement, AMC provided school officials in Tirana and Durres with 100 SIM cards and free text messages. School officials are now able to contact the parents through text messaging to notify them when students are absent or when there are issues with performance. We believe that collaboration between the educational institutions and families is key to the success of the future generation.

For the sixth consecutive year, AMC awarded scholarships to fifteen distinguished Albanian high school students with excellent academic performance. This program aims to improve education quality, to encourage and promote endeavours for higher education, as well as to establish sustainable and qualified human resource bases, which will ultimately benefit both the public and private sector.





AMC është e vetëdijshme për nevojat dhe kërkesat e shoqërisë
AMC recognizes the needs and the requirements of the society







Ky projekt u implementua në të gjithë vendin dhe në të gjitha universitetet publike. Dhënia e bursave studentëve më të mirë dëshmon përkushtimin vendimtar të AMC-së për përmirësimin e jetës, si dhe krijimin e një brezi të shkëlqyer drejtuesish. AMC e konsideron investimin në arsim si shumë të rëndësishëm dhe në përputhje me vizionin e saj, i cili shtrihet përtej synimeve thjesht afarshkurtra, pasi ai është investim për një të ardhme më të mirë.

Gjatë vitit 2007 AMC ka dhënë kontributin e saj për ndërtimin e një shkolle të re fillore në fshatin Labinot, të qarkut të Elbasanit, ku tani mësojnë 70-75 fëmijë. Shkolla e re zëvendësoi ndërtesën e vjetër, e cila po shembej dhe përbënte një rrezik të vazhdueshëm për fëmijët gjatë orëve të mësimit. Përveç kontributit në ndërtimin e shkollës, AMC i dhuroi edhe një bibliotekë me 75 tituj librash shkollës së këtij fshati të largët.

Një tjetër kontribut i AMC-së në fushën e arsimit ka qenë dhurimi i 12 kompjuterave shkollës fillore "7 Marsi" në Tiranë, duke ngritur në këtë mënyrë laboratorin kompjuterik për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së të mësuarit. Kjo ishte një ndër iniciativat e shumta të ndërmarra nga AMC në kuadër të programit të dhurimit të kompjuterave.

Për të dytin vit radhazi, AMC mbështeti iniciativën e të rinjve "Internships 2007", duke shfaqur dhe një herë përkushtimin e saj të plotë ndaj arsimit në Shqipëri, si dhe për strategjinë kombëtare të thithjes së trurit në vend . Kjo iniciativë e organizuar nga Rrjeti i Studentëve Shqiptarë në Botë (ASAN) synon të krijojë mundësi praktike për studentët që kthehen pasi janë diplomuar jashtë vendit. Përmes kësaj iniciative janë mundësuar 420 vende pune në sektorin publik dhe privat, duke mundësuar kështu që disa nga profesionistët shqiptarë më të mirëarsimuar të punojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

The project was implemented nationwide in all public universities. The awarding of these scholarships is a crucial part of AMC's commitment to help improve the life of Albanian citizens, specifically ensuring a bright generation of leaders. Investing in education complies with our vision that extends beyond just short term goals, investing for a better future.

During 2007, AMC contributed for the construction of a new elementary school in Labinot, a village in the Elbasan region, which now hosts 70-75 children. The new school replaced a run down school building where children were under continuous risk during school hours. In addition to contributing for the school construction AMC also donated a library of 75 book titles to the school of the remote village.

Another contribution of AMC to the development of the Albanian educational system was the donation of twelve personal computers to the "7 Marsi", elementary school in Tirana, which aims to establish a computer laboratory to enhance the quality of learning. This initiative was one of the many of its kind, taken in the framework of AMC's computer donation program.

AMC has supported for the second year in a row the youth initiative "Internships 2007", demonstrating its strong commitment to education in Albania and the promotion of Brain Gain. Organized by the Albanian Students Abroad Network, the initiative is aimed at providing internship positions for returning students that have obtained their higher education degrees abroad. 420 positions are available in both the private and the public sector through this initiative, enabling some of the well-educated Albanian professionals to work and contribute to Albania's developing economy.



**Sporti**

E ndërgjegjshme për rëndësinë që ka sporti për shëndetin e qytetarëve, AMC i qëndron besnike kontributit të saj të vazhdueshëm në zhvillimin e sporteve në Shqipëri. Në vitin 2007, AMC ofroi mbështeje si për zhvillimin e sporteve profesioniste, ashtu dhe për promovimin e kulturës së sporteve në të gjithë vendin. Objektivat në këtë fushë, AMC i ka realizuar me sukses nëpërmjet nismave të saj dhe partneritetit me institucione të tjera.

Në përpjekjen e saj për të kontribuar në zhvillimin e sporteve profesionale në Shqipëri, AMC mbështeti financiarisht ekipin e basketbollit të Tiranës për meshkuj dhe atë për femra. Kjo mbështetje do të vazhdojë si një përpjekje për të krijuar një lidhje afatgjatë midis këtyre dy subjekteve.

Kultura sportive kultivohet në moshat e reja, por angazhimi duhet ndjekur më tej edhe me moshat e rritura. Bazuar në këtë koncept, "ALBAKARTA Minifutboll", pjesë e një tradite trevjeçare, ishte gjithashtu një tjetër projekt i suksesshëm i AMC-së gjatë vitit 2007. Duke bashkuar qindra futbollistë amatorë në një kampionat, i cili u zhvillua në 8 qytete, AMC inkurajon shpirtin e garës dhe arritjeve, si dhe promovon sportet si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit.

Në vazhdën e përkushtimit të saj ndaj sporteve, AMC po mbështet gjithashtu edhe mundësin shqiptar Sahit Prizreni, duke e ndihmuar atë të kualifikohej dhe të përfaqësonte Shqipërinë në Lojrat Olimpike Pekin 2008. z. Prizreni është fitues i medaljes së Bronxtë në Europë dhe një nga mundësit më të mirë sot në Shqipëri. AMC ka kontribuar gjithashtu në inkurajimin dhe mbështetjen e atletëve shqiptarë për t'u bërë pjesë e Ekipit Olimpik shqiptar në Pekin.

**Sport**

Aware of the important role that sports play in maintaining a healthy society, AMC remains faithful to continuously contribute in the development of sports in Albania. In 2007 AMC offered its support to the professional sports in Albania as well as to the nationwide promotion of a culture of sports in the country. These goals have been set and successfully carried out through several initiatives from AMC alone or in partnership with additional institutions.

In its endeavor to contribute to the development of professional sports in Albania, AMC has financially supported the Tirana Basketball team for men and women. The support will continue in an effort to establish a long lasting bond between the two entities.

The sports culture is cultivated from the early years but the commitment should be followed through into the adult years as well. Based on this concept, the "ALBAKARTA Mini-football", part of a tradition in its third year, was yet another successful AMC initiative in 2007. By brining together hundreds of amateur football players in a championship that covers 8 cities, AMC hopes to encourage a spirit of competitiveness and achievement among young people as well as promote sports as a healthy way of living.

Continuing its commitment to sports in Albania, AMC is also supporting the Albanian wrestler Mr. Sahit Prizreni, assisting him in qualifying to represent Albania in the Olympic Games of Beijing in 2008. Mr. Prizreni is a former Bronze European Medalist and one of the best wrestlers in Albania today. AMC has contributed to encourage and support Albanian athletes to become part of the Beijing Albanian Olympic Team.

## Arti dhe kultura

Edhe gjatë vitit 2007, AMC ka vazhduar të mbështesë ngjarje të shumta kulturore dhe artistike me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare të Shqipërisë e njekohësisht mbështetjen e këtyre iniciativave jashtë vendit. Një kontribut i ndjeshëm është dhënë për organizimin e ngjarjeve artistike, duke inkurajuar kështu të rinj të talentuar në fushën e muzikës, arteve vizive, fotografisë, grafikës etj.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve, AMC ka mbështetur edicionin e 8-të të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove, i cili organizohet nga Qendra Kombëtare e Teatrit Mesdhetar. Ishte qyteti i lashtë i Butrintit ai që mikpriti kompanitë teatrore nga Shqipëria, Bullgaria, Serbia, Rumania, Maqedonia, Greqia dhe Anglia. "Medea" e Euripidit, "Berberi i Seviljes" së Bomarshe-së dhe "Nata e Dymbëdhjetë" e Shekspirit ishin disa nga pjesët e luajtura për më shumë se një javë.

Në vazhdim të asaj që është kthyer tashmë në një traditë, AMC festoi "Ditën e Verës" në Tiranë, Elbasan dhe qytete të tjera kryesore të vendit. Me këtë rast, një shumëllojshmëri aktivitetesh u organizuan gjatë gjithë ditës si:

- Maratona "Vrapo me Verën" me 600 nxënës të shkollave të mesme.
- Koncerte të muzikës bashkëkohore të luajtur nga artistë të rinj në një skenë të lëvizshme në qendër të qytetit.
- Një paradë dhe aktivitete të tjera festive argëtuan vizitorët e shumtë gjatë kësaj feste kombëtare.

## Art and culture

During 2007 AMC has continued to support numerous cultural and artistic events, aiming at preserving the national cultural heritage of Albania, as well as supporting initiatives for its promotion beyond borders. A large donation has gone to artistic events encouraging talented young Albanians in the music field, visual arts, photography, graphics etc.

AMC in cooperation with the Ministry of Culture, Tourism, Youth and Sports has strongly supported the 8th edition of International Theatre Festival, organized by the National Center of Mediterranean Theatre. The ancient city of Butrint hosted theatre companies from Albania, Bulgaria, Serbia, Romania, FYROM, Greece, and England performing famous pieces such as "Medea" from Euripides, "The Barber of Seville" from Beaumarchais, "The Twelfth Night" from Shakespeare, in more than a week.

Continuing what has now become a tradition, AMC celebrated "Summer Day" in Tirana, Elbasan, and other major cities. A variety of activities were organized through out the day, such as:

- "Run with summer" marathon with 600 secondary school pupils
- Concerts of contemporary music performed by famous young artists on a mobile stage in the city square.
- A parade and other festive activities entertained the crowd of visitors during this national holiday



Edhe një herë, AMC ka kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e artit dhe kulturës në Shqipëri, duke mbështetur për të tretën herë festivalin e filmit për fëmijë "Giffoni". Ky festival ka për qëllim të prezantojë fëmijët me kinematografinë dhe të gjejë mënyrat për të prodhuar filma shqiptarë për të rinj.

Edicioni i tretë i festivalit të filmit për fëmijë "Giffoni" pati një shtrirje të gjerë në shumë qytete në mbarë vendin, duke tërhequr mijëra fëmijë dhe adoleshentë.

Duke e konsideruar librin si një element vendimtar të kulturës dhe rrugës drejt dijes, AMC ka mbështetur për të tretën herë Panairin e Librit që u organizua nga "Shoqata e Botuesve Shqiptarë". Gjatë Panairit të Librit në Tiranë, "Çmimi AMC" iu dha dy vëllimeve të para të botimit "Ismail Kadare, pjesë të zgjedhura", për cilësinë e lartë dhe teknikën moderne të printimit.

AMC ka qenë mbështetësja kryesore e koncertit të përvitshëm "Kënga Magjike", që promovon profesionistët e industrisë së muzikës në Shqipëri, duke nxitur vazhdimisht artistët e rinj të ndjekin ëndrrat dhe karrierën e tyre.

Ekspozita "Trego një histori" mblodhi një grup ambicioz dhe të përzgjedhur artistësh të rinj, të cilët i shprehën të papriturat dhe të fshehtat e historive të tyre përmes pikturave, grafikës, aplikacionit dhe multimediave. Kjo ekspozitë u mbështet nga AMC-ja, si një mënyrë për të promovuar dhe nxitur talentet e reja të kësaj fushe.

AMC has demonstrated once again its contribution to the development and promotion of arts and culture in Albania, by giving its support for the third time to "Giffoni Film Festival." The festival aims to introduce the children to cinematography and to find ways to produce Albanian movies for young people.

The third edition of Giffoni Film Festival in Albania had a large extension in many cities around the country, attracting thousands of children and teenagers.

Considering the book to be a crucial element of culture and the path toward knowledge, AMC has supported for the third time the Book Fair organized from the Albanian Publishers Association. During the Book Fair in Tirana the AMC Prize was awarded to the first two volumes of "Ismail Kadare, Selected Works", for the high quality and modern printing techniques.

AMC generously sponsored the annual Magic Song Concert, which promotes the professionals of the Albanian music industry, continuously encouraging the young artist in pursuing their dreams and promoting their carriers.

"Tell a Story" exhibition gathered an ambitious and selective group of young artists that expressed the surprises and secrets of their stories through pictures, graphics, applications, and multimedia. The exhibition was supported by AMC as a way to promote and encourage the young talents in the field.



Ne kemi detyrimin të kujdesemi për planetin, është shtëpia jonë e vetme

We have the responsibility to look after our planet because it is our only home



# Angazhimi i AMC-së ndaj mjedisit

Si pjesë e përpjekjes së pakursyer për kujdesin ndaj mjedisit, gjatë vitit 2007 AMC ka ndërmarrë një nismë për rehabilitimin e Parkut Kombëtar të Llogarasë. Janë mbjellë rreth pesëmbëdhjetë mijë pemë të reja në një sipërfaqe prej gjashtë hektarësh. Kjo nismë mishëron përkushtimin për përgjegjësinë sociale të AMC-së ndaj komunitetit të cilit i shërben dhe mjedisit në të cilin ushtron aktivitetin.

Në kuadër të angazhimit ndaj komunitetit, AMC i është përgjigjur në mënyrë të menjëhershme Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Admistrimit të Ujrave, duke dhënë mbështetjen e saj për aktivitetet e organizuara në ditën ndërkombëtare "Një ditë pa makinën time". Këto aktivitete kishin për qëllim sensibilizimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe mënyrat se si gjithëkush mund të kontribuojë në ruajtjen e planetit.

Ruajtja e burimeve natyrore është detyrë e çdo individi të shoqërisë sonë. Gjatë vitit 2007, AMC mbështeti programin "Miqtë e Ujit", nismë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me Shoqatën e Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë. "Të ruajmë dhe të mbrojmë burimet ujore" ka qenë slogani i këtij programi, i cili synon të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve mbi rëndësinë e ruajtjes së burimeve ujore. Nxënës nga disa shkolla fillore të përzgjedhur në të gjithë Shqipërinë prezantuan idetë dhe projektet të tyre rreth problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me burimet ujore, rëndësinë dhe mbrojtjen e tyre.

# AMC's Commitment to the Environment

As part of its evident effort to encourage environmental awareness in Albania, AMC undertook an initiative to rehabilitate the Llogara National park. Around fifteen thousand new trees were planted covering an area of 6 hectares. This initiative embodies AMC's social responsibility devotion to improving the community we serve and the environment in which we operate.

As part of its commitment to the community, AMC has promptly responded to the Ministry of the Environment, Forests, and Water Management by providing support for the activities organized for the international day "A day without my car". The activities aim to increase people's awareness on issues of environmental protection and how each individual can help in saving our planet.

Preserving natural resources is the duty of each and every individual citizen. During 2007, AMC supported the "Water Friends" program, initiated by the Ministry of Education and Sciences, in close collaboration with the Water Supply and Sewage Association of Albania. "Conserve and protect our water resources" was the slogan of the program, which aims to increase children's awareness of the importance of conserving water resources. Pupils of selected elementary schools across Albania have presented their own individual ideas and small projects about the different issues concerning water resources, their importance and protection.



Gjithmonë drejt arritjeve të mëdha

Thinking and planning great achievement



## Vizioni ynë për të ardhmen

Pas 12 vjetësh kontributi në shoqëri, ekonomi dhe mjedis, AMC do të vazhdojë ta konsolidojë filozofinë e saj rreth veprimtarisë së përgjegjshmërisë sociale me të njëjtin përkushtim, interes dhe dëshirë. Qëllimi i AMC-së është të vazhdojë te japë kontributin e saj për zhvillimin e shoqërisë dhe mjedisit shqiptar, ku ajo zhvillon veprimtarinë, duke u bërë një shembull për t'u ndjekur edhe nga kompanitë e tjera. Me një vizion të qartë për të ardhmen, funksionimi sot si një biznes i përgjegjshëm për AMC do të thotë të hedhësh themelet për suksese të mëtejshme.

Kompania AMC ka perceptime të qarta mbi rritjen dhe zhvillimin e secilit nga sektorët e saj operativë.

**Në lidhje me Burimet Njerëzore**

AMC synon të punësojë, të zhvillojë dhe të motivojë profesionistët më të mirë. Nëpërmjet manaxhimit të burimeve njerëzore, të orientuara drejt biznesit dhe tregut, AMC synon të arrijë rezultate të shkëlqyera, si për punonjësit, ashtu dhe për kompaninë si një e tërë. AMC do të vazhdojë të ndjekë nga afër vlerësimet dhe shqetësimet e punonjësve dhe në përputhje me reagimet e tyre do të përshtasë praktikat e saj drejtuese.

Duke synuar për më tepër pjesëmarrje të strukturave të ndryshme të kompanisë në krijimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të përgjegjshmërisë sociale, AMC ka ngritur sektorin e Përgjegjshmërisë Sociale, qëllimi i të cilit është të sigurojë vënien në jetë të objektivave të kompanisë në këtë fushë dhe njëkohësisht të garantojë një shkëmbim të dyanshëm të informacionit dhe njohurive lidhur me çështje të kësaj natyre.

## Our Vision for the Future

After twelve years of contribution to the society, economy and environment, AMC will continue to consolidate its philosophy about social responsible action into a work of substance with the same determination, eagerness and willingness. AMC's goal is to continue its contribution to the prosperity of the Albanian society and the environment within which it successfully operates. With regard to its social activity, AMC aims at becoming a model of responsibility that will drive other companies as well into being actively involved. The company will fully utilize the foundations it has laid in previous years, its relationship with social partners and empower them through contemporary practices, policies and its dynamic strategy of Social Responsibility. AMC has a clear set vision for the future. For AMC, operating a responsible business today means laying the ground for a successful company in the future. The company has insights on growth and development for each of its operating parts.

**Regarding Human Resources**

AMC aims to hire, develop, motivate and retain the best professionals. AMC seeks to achieve both company and individual excellence through business and market oriented human resources management. AMC will continue to closely monitor employee satisfaction and adjust management practices accordingly.

Furthermore aiming at the effective participation of the company's operating units in the formation and implementation of the Social Responsibility best practices, AMC has proceeded with the introduction of the CSR team. This team's goal is to safeguard the implementation of the social responsibilities through all of the company's operating units and to ensure the two-way exchange of information and knowledge with regard to social responsibility issues.

### Në lidhje me klientët

AMC do të vazhdojë të ofrojë cilësi, vlera dhe shërbime të shkëlqyera për klientët e saj, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së jetës së tyre e duke e bërë komunikimin të prekshëm nga të gjithë.

Një nga qëllimet e AMC-së për vitin 2008 do të jetë afrimi drejt grupeve sociale të ndjeshme në Shqipëri, duke ofruar dhe zhvilluar shërbime dhe produkte të integruara.

Kompania do të vazhdojë t'i trajtojë klientët me respektin që meritojnë dhe vëmendjen që vetëm një kompani si AMC mund të ofrojë.

### Në lidhje me shoqërinë

AMC do të vazhdojë të kontribuojë për shoqërinë shqiptare në bazë të nevojave të saj. Nëpërmjet këtij kontributi AMC synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe motivimin për përshtatjen e standardeve, të cilat synojnë përmirësimin real të cilësisë së jetës dhe zgjidhjen e nevojave emergjente të grupeve të veçanta të popullsisë. Përmes shqyrtimit të rezultateve të kontributit që ka dhënë më parë për shoqërinë, kompania do të ketë mundësi të përqendrohet më tepër në aktivitete të cilat përbëjnë prioritet për shoqërinë e sotme shqiptare.

Për të mundësuar një dialog të hapur mes klientëve, aksionerëve dhe AMC-së, ne ju nxisim të na kontaktoni në adresën e postës elektronike mediarelations@amc.al, për të na dërguar vërejtjet dhe sugjerimet tuaja. Ne përpiqemi vazhdimisht që të garantojmë përmbushjen e kërkesave të klientëve tanë, jo vetëm me shërbime tona, por edhe me përfshirjen sociale dhe kontributin tonë. Për më tepër, ne besojmë se forcimi i marrëdhënieve me klientët mbetet çelësi i suksesit të kompanisë sonë.

### Regarding Customers

AMC will continue its genuine efforts to deliver quality, value and excellent services to its customers in order to enhance the quality of life and continue to make communication available to all residents of Albania.

One of the company's main goals for 2008 will be to target specific social groups through the creation and development of integrated products and services.

The company will continue to treat its customers with the invaluable respect that they deserve and with the attention that only a company such as AMC can deliver.

### Regarding Society

AMC will continue to contribute based on the recognized needs of the Albanian society. This contribution will be aiming to enhance awareness and motivation for the adoption of the standards that relate to a real improvement to the quality of life and help in resolving the immediate needs of specific population groups. Furthermore by reviewing the results of the previous contribution to the society, the company will have the opportunity to continuously improve and focus on effective activities that constitute a priority for today's Albanian society.

To enable an open dialogue among customers, stakeholders and AMC we encourage you to contact us at mediarelations@amc.al with any comments or suggestions that you may have. We are continuously striving to ensure customer satisfaction not only with our services but also with our social involvement and contributions. Moreover, we strongly believe that strengthening our relation with our customers remains the key to our success as a company.









Mundësi për brezat e ardhshëm
Chances for the future generation





AMC do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë zhvillimin e shoqërisë demokratike, duke promovuar pjesëmarrjen aktive qytetare, si dhe shërbimet vullnetare. Kompania AMC do të jetë pjesëmarrëse aktive në përpjekjet e Shqipërisë për t'ju bashkuar familjes se madhe Evropiane.

**Në lidhje me mjedisin**

AMC do të rrisë rolin në manaxhimin dhe uljen e rrezikut mjedisor. AMC do të nisë një projekt për riciklimin e telefonave celularë të abonentëve të saj, si dhe do të nxisë nisma dhe fushata, të cilat do të udhëheqin brezat drejt një ekosistemi të pastër dhe të shëndetshëm. Brenda mjedisit të punës, AMC do të nxisë punonjësit e saj që të jenë përgjegjës për një mjedis të pastër.

Për vitin 2008, AMC do të angazhohet në një sërë sfidash, të cilat do të kenë si synim pjesëmarrjen aktive të kapaciteteve njerëzore në iniciativa të lidhura me:

- ruajtjen e konsumit të burimeve natyrore (p.sh., ujë, letër)
- kursimin e energjisë (p.sh., karburante dhe energji elektrike)
- shëndetin (rrezatimin elektro-magnetik)
- riciklimin e materialeve (letër, plastikë, aparate celularë)

**Në lidhje me furnitorët dhe partnerët**

AMC bën përpjekje maksimale për të pasur marrëdhënie të drejta dhe profesionale me furnitorët, të mbështetura në sinqeritet, besim dhe përkushtim. AMC do të vazhdojë të zbatojë parimet e përgjegjësisë sociale në procesin e menaxhimit të rrjetit të furnitorëve.

AMC will continue to encourage and support the development of a democratic society, promoting active civic participation as well as voluntary services. The company seeks to be a dynamic player on paving the road to joining the European Union societies.

**Regarding the Environment**

AMC will increase the role in managing and reducing the environmental risk in the communities in which it conducts its business. AMC will ensure proper disposal of the mobile telephones from its customers as well as it will encourage through initiatives and campaigns a generation that values a clean and healthy eco-system. Within its work environment, AMC will encourage environmental awareness among its employees.

Our goal for 2008 will be taking on a series of challenges that will target its human resources' active participation in initiatives related to:

- natural resources consumption saving (e.g. water, paper)
- energy saving (e.g. petroleum, electrical energy)
- health (electro magnetic radiation)
- recycling of materials (paper, plastic, mobile phones etc.)

**Regarding suppliers and partners**

AMC strives for fair and professional relationships with its suppliers, based on honesty, trust and commitment. The company will apply its Social Responsibility principles in the supply chain management process.







## Jetojmë dhe zhvillohemi së bashku
## Living and prospering together







AMC, kompania nr. 1 e telefonisë celulare në Shqipëri
AMC, the leading mobile operator in Albania

# Reagimi juaj është i rëndësishëm

Në përpjekje për të vendosur ura komunikimi ndërmjet kompanisë sonë dhe klientëve tanë besnikë, si dhe për të ruajtur standardet e larta të transparencës, këtë vit ne kërkojmë mendimin tuaj nëpërmjet anketës sonë elektronike mediarelations@amc.al. Në përputhje me synimin tonë për përsosmëri në gjithçka që bëjmë, ne ftojmë lexuesit tanë të na ndihmojnë në përmirësimin e Raportit tonë Vjetor të Përgjegjshmërisë Sociale. Me ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj, ne do të jemi në gjendje që të trajtojmë çështje të rëndësishme në adresë të klientëve dhe të gjithë banorëve, si pjesë e komunitetit ku ne operojmë. Dëshirojmë t'ju sigurojmë se mendimi juaj do të merret në konsideratë dhe do të vlerësohet shumë.

# Your Feedback Matters

In an effort to open up the lines of communication between our company and our loyal customers as well as to uphold high standards of transparency, this year we are asking for your feedback through mediarelations@amc.al. In accordance with our aim for excellence in everything that we do, we invite our readers to help us improve our yearly Corporate Social Responsibility report. With your help and collaboration we will be able to address issues that are important to our customers and all citizens in the communities where we operate. We want to assure you that your feedback will be taken in consideration and is greatly appreciated.



amc
COSMOTE GROUP

Pjesëmarrje
Participation

COSMOTE GROUP

KOMPANIA NR. 1 E TELEFONISË CELULARE NË SHQIPËRI
THE LEADING MOBILE OPERATOR IN ALBANIA

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS - "Gjergj Legisi" - Laprakë - Tiranë
Tel.: +355 4 275 000 - 139  FAX: +355 4 257 331 - www.amc.al